



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.36

Prishtinë, më 2.12.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviq, Shpejtim Bulliqi dhe Bekim Haxhiu.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Arsim Bajrami, ministër i MASHT; Kujtim Shala, ministër i MKRS-së; përfaqësues të KDI-së dhe NDI-së; Zyra e Presidentes dhe media.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24 dhe 25.11.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016:
 - 3.1. Projektbuxheti për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - 3.2. Projektbuxheti për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 3.3. Projektbuxheti për Ministrinë e Diasporës.
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me plotësimin e tij me një pikë të re: **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.**

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24 dhe 25.11.2015

Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 24 dhe 25.11.2015, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

3.1. Projektbuxheti për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Nait Hasani, tha se projektbuxheti i fushës së arsimit për vitin 2016, është vërejtur se ka zvogëlim të tij, krahasuar me vitin paraprak. Lidhur me këtë, përmendi edhe sfidat që dalin nga raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, ku përmbushja e tyre kërkon kosto shtesë buxhetore, veçanërisht për fëmijët me nevoja të veçanta dhe kategorive tjera.

Salih Morina, në diskutimin e tij foli për planifikimet buxhetore për vitin 2016, me theks të veçantë për miratimin dhe implementimin e Ligjit për njohjen e stazhit të punës për punëtorët e arsimit në periudhën 1990 – 1999, i cili kërkon kosto shtesë buxhetore. Sa i përket çështjes së pedagogëve në shkolla, kërkoi sqarim lidhur me përfshirjen e tyre, si dhe mundësitë buxhetore për implementimin e këtij projekti.

Shpejtim Bulliqi, tha se ngritja e cilësisë në arsim, bëhet njëkohësisht me ngritjen e buxhetit. Lidhur me grandet nëpër Komuna, tha se MASHT-i duhet të analizojë dhe ndryshoj formulën e mbi bazën e të cilës bëhet ndarja e grandeve. Ai vlerësoi pozitivisht zvogëlimin e buxhetit për botimin e librave shkollorë që jepen falas, ndërsa foli edhe për financimin e përvojës së mësimitdhënësve të viteve 1990 – 1999, si proces të domosdoshëm.

Bekim Haxhiu, në diskutimin e tij lidhur me projektbuxhetin për vitin 2016, tha se në këtë projektbuxhet duhet të planifikohet kategori buxhetore për vendosjen e dollapëve në shkolla. Ky proces duhet të bëhet në koordinim me Këshillin e Prindërve të Kosovës dhe drejtoritë komunale të arsimit. Sa i përket projekteve të infrastrukturës shkollore, ai kërkoi sqarim lidhur me shkollat e papërfunduara nga viti 2008, ku përmendi shkollën e fshatit Qirez, shkollën e mesme “Hamëz Jashari” në Skenderaj dhe shkollën në Qubrel.

Ministri Arsim Bajrami, në diskutimin e tij, foli për planifikimet buxhetore të parapara në projektbuxhetin për vitin 2016 në fushën e arsimit, shkencës dhe teknologjisë. Ai tha se buxheti i

ndarë për fushën e arsimit, siguron një funksionim rutinor të MASHT-it, por jo edhe reforma substanciale në arsim, trajnim të mësimdhënësve dhe modernizimin e teksteve shkollore. Ai foli edhe për subvencionet dhe donacionet në fushën e arsimit, hulumtimeve, si dhe lidhur me kredinë e Bankës Botërore, përmes së cilës, me projekte të caktuara, do të ketë mundësi të përfitimit çdo shkollë në Kosovë.

3.2. Projektbuxheti për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Nait Hasani, lidhur me projektbuxhetin e vitit 2016 për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, tha se zvogëlimi i buxhetit, krahasuar me vitin paraprak, mund të ndikojë në mos përmbushjen e projekteve të parapara.

Salih Morina, tha se ka analizuar projektbuxhetin për vitin 2016 dhe nga ajo që ka vërejtur është se MKRS, ka më së paku zvogëlim të buxhetit, në krahasim me ministritë tjera. Kërkoj sqarim lidhur me projektet e papërfunduara të Teatrit të Operës dhe Baletit dhe Muzeut të Arteve Bashkëkohore.

Shpejtim Bulliqi, tha se zvogëlimi i buxhetit në kategorinë e investimeve, është një lajm jo i mirë, kur kemi parasysh se ndërkombëtarizimi i sportit nuk mund të bëhet pa investuar e përmirësuar infrastrukturën sportive.

Bekim Haxhiu, tha se zvogëlimi i buxhetit për MKRS-në, sidomos në kategorinë e investimeve kapitale, do të shkaktojë vonesa në përfundimin e punimeve në infrastrukturën sportive, të projekteve që kanë filluar, por edhe të atyre projekteve që planifikohen të ndërtohen, siç është rasti i vazhdimit të punimeve në stadiumin olimpiq “Adem Jashari” në Mitrovicë, renovimi i stadiumit të Prishtinës, ndërtimi i stadiumit kombëtar në Prishtinë, palestrat sportive të filluara më parë në komunat e ndryshme të Kosovës, si dhe çështja e stadiumeve ndihmëse të financuara nga BE, po ashtu kanë mbetur të papërfunduara.

Sergjan Popoviq, kërkoj sqarim nga ministri lidhur e atë se a ka pasur kërkesa nga komunitetet jo shumicë që i janë adresuar MKRS-së për realizim të ndonjë projekti.

Ministri Kujtim Shala, tha se projektbuxheti për vitin 2016 i plotëson nevojat e MKRS-së për të përmbushur obligimet e saj. Sa i përket çështjes së ndërtimit të stadiumit kombëtar në Prishtinë, tha se në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, jemi përcaktuar për lokacionin se ku do të ndërtohet, mirëpo ndërkohë na është paraqitur një kontest pronësor dhe jemi duke punuar në zgjidhjen këtij kontesti. Sa i përket projekteve dhe kontratave që nuk janë përmbushur, ministri tha se pas një procesi të auditimit, do t'i ndjekin procedurat për mospërmbushje të kontratës sipas afateve të parapara.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive

Nait Hasani, tha se Projektligji për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive, u është shpërndarë deputetëve më 25 nëntor 2015, dhe sipas Rregullores së Kuvendit, i plotëson kushtet për shqyrtim, para miratimit në parim në mbledhje plenare.

Ministri Kujtim Shala, prezantoi Projektligjin dhe theksoi arsyen e miratimit të tij si ligj i rëndësishëm së veçantë, me të cilin synohet të rregullohet baza juridike për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive. Ministri, po ashtu, tha se MKRS-ja, në kuadër të kompletimit të legjislacionit në fushën sportit, shumë shpejt do të procedojë edhe Projektligjin për menaxhimin e objekteve sportive.

Anëtarët e Komisionit, pas debatit, theksuan se shqyrtimi dhe amendamentimi i këtij projektligji kërkon një angazhim të veçantë, duke pasur parasysh rëndësinë e tij.

Pas diskutimeve, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim, Projektligji nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.

5. Të ndryshme

Për këtë pikët të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

Përgatitur nga: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani